


Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Shtator 2022

Tiranë, më 10 Tetor 2022: Indeksi i Çmimeve të Konsumit në muajin Shtator 2022, arriti 110,8 kundrejt muajit Dhjetor 2020.

Ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të konsumit në muajin Shtator 2022 është 8,1 %, një vit më parë ky ndryshim ishte 2,5 %. Ndryshimi mujor i indeksit të çmimeve të konsumit në muajin Shtator 2022, krahasuar me Gusht 2022 është 0,6 %.

Fig. 1 Ndryshimet vjetore të Indeksit të çmimeve të konsumit (%)




Ndikimi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të indeksit të çmimeve të konsumit.

Rritja vjetore e çmimeve në muajin Shtator është ndikuar kryesisht nga grupi “Ushqime dhe pije joalkoolike” me +4,91 pikë përqindje, pasuar nga grupi “Transporti” me +0,99 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” me +0,64 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë” me +0,41 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Pije alkoolike dhe duhan” me +0,32 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Hotele, kafene dhe restorante” kanë kontribuar me +0,28 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Mallra dhe shërbime të ndryshme” me +0,17 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Argëtim dhe kulturë” me +0,13 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Veshje dhe këpucë” me +0,11 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Shërbimi arsimor” me +0,05 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Shëndeti” me +0,04 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Komunikimi” me +0,03 pikë përqindje.

Për publikim 10/10/2022

Fig. 2 Ndikimi i grupeve në ndryshimin vjetor



Ndryshimet vjetore të grupeve kryesore: Krahasuar me muajin Shtator 2021, rritja më e madhe e çmimeve vërehet në grupin “Transporti” me 17,2 %, pasuar nga grupet “Ushqime dhe pije joalkoolike” me 14,0 %, “Pije alkoolike dhe duhan” me 6,5 %, “Hotele, kafene dhe restorante” me 6,4 %, “Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë” me 5,5 %, “Argëtim dhe kulturë” me 4,7 %, “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” me 3,3 %, “Veshje dhe këpucë” me 3,0 %, “Mallra dhe shërbime të ndryshme” me 2,9 %, “Shërbimi arsimor” me 1,8 %, “Shëndeti” dhe “Komunikimi” me 0,9 % secili.

Brenda grupit të ushqimeve çmimet e nëngrupit “vajra dhe yndyrna” u rritën me me 30,0 %, pasuar nga nëngrupet “qumësht, djathë dhe vezë” me 24,0 %, “bukë dhe drithra” me 17,3 %, “peshk” dhe “sheqer, recel, mjaltë, çokollata dhe mbëlsira” me 15,1 % secili, “mish” me 12,0 %, “zarzavate përfshirë patatet” me 8,5 %, etj.

Ndryshimet mujore të grupeve kryesore: Krahasuar me muajin Gusht 2022, çmimet e grupit “Veshje dhe këpucë” u rritën me 2,1 %, pasuar nga grupet “Shërbimi arsimor” me 1,6 %, “Ushqime dhe pije joalkoolike” me 1,1 %, “Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë” dhe “Mallra dhe shërbime të ndryshme” me 0,9 % secili, “Hotele, kafene dhe restorante” me 0,4 %, “Pije alkoolike dhe duhan”, “Shëndeti” dhe “Argëtim dhe kulturë” me 0,3 % secili, “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” me 0,2 %. Nga ana tjetër, çmimet e grupit “Transporti” u ulën me 1,7 %.

Tab. 1 Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Dhjetor 2020=100

Kodi	Grupet	Peshat	09-21	10-21	11-21	12-21	01-22	02-22	03-22	04-22	05-22	06-22	07-22	08-22	09-22
	Gjithsej	100	102,5	102,7	102,8	103,7	105,0	106,4	108,9	109,7	109,2	109,0	109,3	110,1	110,8
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	35,1	104,6	104,5	104,3	106,4	109,9	113,4	117,8	119,1	117,2	115,6	116,2	118,0	119,3
2	Pije alkoolike dhe duhan	5,1	101,2	101,5	101,5	102,1	102,9	103,3	106,3	105,8	106,3	106,3	106,8	107,4	107,7
3	Veshje dhe këpucë	3,8	101,2	101,6	101,5	101,7	101,3	100,9	101,5	101,4	101,6	101,7	102,3	102,0	104,2
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	19,3	101,1	101,3	101,7	101,9	102,0	102,0	102,5	102,8	103,2	103,2	104,0	104,2	104,4
5	Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	7,4	100,7	100,7	101,0	101,2	101,5	101,7	102,6	103,3	103,9	104,5	105,0	105,4	106,3
6	Shëndeti	4,4	100,7	100,7	100,8	100,9	100,8	100,9	100,9	100,8	100,8	101,0	101,3	101,3	101,6
7	Transporti	6,0	105,1	106,9	108,5	109,0	109,2	111,2	121,1	123,9	124,6	130,2	125,3	125,3	123,2
8	Komunikimi	3,1	102,9	103,2	103,2	103,3	103,3	103,3	103,3	103,6	103,6	103,4	103,7	103,9	103,9
9	Argëtim dhe kulturë	2,5	102,2	102,6	104,0	104,2	104,2	102,8	103,2	106,0	102,7	101,3	101,2	106,7	107,0
10	Shërbimi arsimor	3,0	100,8	100,4	100,5	100,5	100,5	100,6	100,8	100,8	100,8	100,8	100,9	100,9	102,6
11	Hotele, kafene dhe restorante	4,7	101,5	101,9	102,4	103,3	103,6	103,9	105,2	105,7	106,2	106,6	107,2	107,6	108,0
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	5,7	99,8	99,7	99,6	99,7	99,7	100,3	100,7	100,9	101,0	101,2	101,6	101,8	102,7

Tab. 2 Ndryshimet vjetore të Indeksit të Çmimeve të Konsumit

%

Kodi	Grupet	09-21/09-20	10-21/10-20	11-21/11-20	12-21/12-22	01-22/01-21	02-22/02-21	03-22/03-21	04-22/04-21	05-22/05-21	06-22/06-21	07-22/07-21	08-22/08-21	09-22/09-21
	Gjithsej	2,5	2,4	3,1	3,7	3,7	3,9	5,7	6,2	6,7	7,4	7,5	8,0	8,1
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	4,6	3,9	5,0	6,4	6,7	6,9	9,3	9,9	11,4	12,6	13,2	14,0	14,0
2	Pije alkoolike dhe duhan	1,5	1,9	1,6	2,1	2,1	2,1	4,9	4,3	5,0	4,7	5,0	6,2	6,5
3	Veshje dhe këpucë	1,9	2,2	1,6	1,7	1,2	1,1	1,5	1,2	1,3	1,6	2,1	1,9	3,0
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	1,0	1,2	1,7	1,9	1,9	1,8	2,3	2,6	2,7	2,8	3,4	3,2	3,3
5	Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	1,1	0,8	1,2	1,2	0,8	0,8	1,4	2,7	3,2	3,8	4,2	4,7	5,5
6	Shëndeti	0,6	0,8	0,8	0,9	-0,1	-0,1	0,0	0,6	0,2	0,3	0,5	0,6	0,9
7	Transporti	4,5	6,8	8,8	9,0	9,0	10,4	19,9	22,5	21,7	26,9	19,7	19,3	17,2
8	Komunikimi	3,0	3,2	3,2	3,3	3,3	3,3	1,9	0,8	0,8	0,6	0,7	0,9	0,9
9	Argëtim dhe kulturë	2,1	2,7	3,8	4,2	3,5	2,7	3,5	4,1	1,2	-0,9	0,2	5,2	4,7
10	Shërbimi arsimor	0,8	0,4	0,5	0,5	0,5	0,5	0,7	0,6	0,6	0,6	0,7	0,7	1,8
11	Hotele, kafene dhe restorante	1,7	1,9	2,4	3,3	3,0	3,2	4,5	4,9	5,3	5,6	6,0	6,2	6,4
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	-0,2	-0,4	-0,5	-0,3	-0,4	0,4	0,9	1,0	0,9	1,0	1,5	1,9	2,9

Tab. 3 Ndryshimet mujore të Indeksit të Çmimeve të Konsumit

%

Kodi	Grupet	09-21	10-21	11-21	12-21	01-22	02-22	03-22	04-22	05-22	06-22	07-22	08-22	09-22
	Gjithsej	0,5	0,1	0,2	0,8	1,3	1,3	2,4	0,7	-0,5	-0,1	0,2	0,8	0,6
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	1,1	-0,1	-0,2	1,9	3,3	3,2	3,9	1,1	-1,6	-1,4	0,6	1,5	1,1
2	Pije alkoolike dhe duhan	0,0	0,3	0,0	0,6	0,8	0,4	2,8	-0,5	0,5	0,0	0,4	0,6	0,3
3	Veshje dhe këpucë	1,1	0,4	-0,1	0,1	-0,3	-0,5	0,7	-0,1	0,1	0,2	0,5	-0,2	2,1
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	0,1	0,3	0,3	0,2	0,1	-0,1	0,6	0,3	0,4	0,1	0,7	0,2	0,2
5	Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	0,1	-0,1	0,4	0,1	0,3	0,2	0,8	0,8	0,5	0,6	0,4	0,4	0,9
6	Shëndeti	-0,1	0,0	0,0	0,1	0,0	0,1	-0,1	0,0	0,0	0,2	0,3	0,0	0,3
7	Transporti	0,0	1,8	1,5	0,5	0,2	1,8	8,9	2,3	0,5	4,5	-3,7	0,0	-1,7
8	Komunikimi	0,0	0,2	0,1	0,0	0,0	0,1	0,0	0,3	0,0	-0,2	0,2	0,2	0,0
9	Argëtim dhe kulturë	0,7	0,4	1,4	0,2	0,0	-1,4	0,4	2,7	-3,1	-1,3	-0,1	5,5	0,3
10	Shërbimi arsimor	0,6	-0,4	0,1	0,0	0,0	0,1	0,2	0,0	0,0	0,0	0,1	0,0	1,6
11	Hotele, kafene dhe restorante	0,2	0,4	0,5	0,9	0,3	0,3	1,3	0,5	0,5	0,5	0,5	0,4	0,4
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	-0,1	-0,2	-0,1	0,1	0,0	0,6	0,4	0,2	0,0	0,2	0,4	0,3	0,9

Metodologjia

Ndryshime metodologjike

Në muajin Janar të çdo viti Indeksi i Çmimeve të Konsumit shoqërohet me disa ndryshime metodologjike sipas metodologjisë ndërkombëtare të llogaritjes së këtij treguesi, të cilat konsistojnë në:

- Përditësimin e peshave: Peshat e mallrave dhe shërbimeve janë ndryshuar duke u bazuar në shpenzimet mesatare të Anketës së Buxhetit të Familjeve 2020.
- Përditësimin e listës së mallrave dhe shërbimeve: Shporta përbëhet nga 331 produkte dhe shërbime.
- Përditësimin e listës së njësive tregtare ku mbliidhen çmimet.

Indeksi i Çmimeve të Konsumit duke filluar nga muaji Janar 2021 do të llogaritet me bazën e re. Muaji Dhjetor 2020 do të shërbejë si periudhë bazë për llogaritjen e indeksit (Dhjetor 2020 = 100).

INSTAT gjatë periudhës së Pandemisë ka ndjekur rekomandimet më të fundit metodologjike të EUROSTAT dhe të partnerëve të tjerë ndërkombëtarë.

Përkufizime

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) është matësi zyrtar i inflacionit në Shqipëri, Indeksi mat ndryshimet relative të çmimeve të mallrave dhe shërbimeve të përdorura nga familjet për konsum vetjak dhe llogaritet duke përdorur strukturën e konsumit final të familjeve shqiptare. Burimi kryesor i informacionit për shpenzimet është Anketa e Buxhetit të Familjeve.

Ndryshimi vjetor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve midis muajit korrent me të njëjtin muaj të vitit të mëparshëm. Ky ndryshim është rrjedhojë e ndryshimeve korente në nivelin e çmimeve, por mund të ndikohet edhe nga efektet e papërsëritshme të cilitdo muaj.

Ndryshimi mujor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve të muajit korrent me muajin e mëparshëm, Ky tregues është i ndjeshëm nga efektet sezonale.

Ndryshimi mesatar 12 mujor mat ndryshimin e indeksit mesatar të konsumit në 12 muajt e fundit me indeksin mesatar të 12 muajve të mëparshëm.